

Procesverbal

*Nga Mbledhja IV (e katërt) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë:
29.04.2024*

Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2) Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për Seancën IV;
- 3) Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, përshëndetje të gjithë që gjendeni në sallë! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen IV të rregullt të KPF-së për vitin 2024! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë. Para se ta hedhim në votim rendin e ditës, nëse ka dikush që do me e marrë fjalën për rendin e ditës?

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, të nderuar anëtarë të KPF-së, të nderuar drejtorë, staf komunal! Ju përshëndes të gjithëve! Qëllimi i daljes time këtu në foltore është që më duhet t'i propozoj dy pika të rendit të ditës. Arsyeja pse duhet t'i propozoj këto është se, në seancën e kaluar Asambleja Komunale ka prurë një vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2023 në vitin 2024. Asambleja Komunale me shumicë votash ka vendosur që këto mjete të ndahen në 13 projekte. Mirëpo, Ministria e Financave nuk e ka bërë bartjen e mjeteve vetanake. Gjithashtu, edhe mjetet të cilat janë grumbulluar më shumë sesa planifikimi, vlera e ta cilave është 90,460.33 euro, nuk e ka bërë bartjen në projektet të cilat ne kemi kërkuar, por ajo ka bërë një bartje tjetër, dhe shumicën e tyre nuk i ka bartur në projektet të cilat i kemi kërkuar ne. Këtë nuk e ka bërë vetëm për Komunën tonë, por për të gjitha komunat e Kosovës. Shumica e komunave kanë thirrur mbledhje të jashtëzakonshme dhe kanë vendosur të bëjnë rialokimin e këtyre mjeteve edhe një herë. Mirëpo ne, pasi e kishim të caktuar mbledhjen e Kuvendit për nesër dhe mbledhjen e Komitetit për sot, ne nuk kemi pas nevojë që të thirrjmë mbledhje të jashtëzakonshme. Andaj, propozoj dy propozim-vendime: Propozim-vendimin për tejkalimin e mjeteve vetanake të buxhetuara në vitin 2023 dhe të barten në vitin 2024. Juve tash jua shpërndanë materialin, s'po i lexoj propozimet. Mjetet vetanake prej 90,460.33 euro të cilat janë grumbulluar më shumë sesa planifikimi, kemi propozuar që të barten në këto projekte, të cilat i keni marrë jut ash propozimin. Gjithashtu, propozoj që pikë tjetër e rendit të ditës të hyjë edhe Propozim-vendimi për rialokimin e mjeteve të buxhetuara për

vitin 2024. Shuma e këtyre mjeteve është 115,788.22 euro. Në faqen e parë i keni mjetet të cilat i ka alokuar Ministria e Financave, jo në bazë të Vendimit tonë, ndërsa në faqen e dytë e keni propozimin tonë për alokimin e këtyre mjeteve në projekte. Nuk është bërë asnjë ndryshim i Propozim-vendimit, duke u bazuar në Vendimin që e ka marrë Asambleja Komunale në seancën e kaluar. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! A do dikush tjetër me e marrë fjalën?

Munir Jonuzi: Faleminderit Zonja Presidente, I nderuar Zotëri, do të doja të komentoja shkurtimisht këtë vendim që sapo morëm. Me sa mbaj mend, ne tashmë e kemi votuar këtë në gusht të vitit të kaluar. Të gjitha këto projekte janë votuar në gusht të vitit të kaluar, jam këtu në këtë foltore vetëm për të vënë në dukje një gabim, ku përmendet ndërtimi i fushës sportive në fshatin Globoçicë dhe janë ndarë 0.50 euro, mendoj se është gabim.

Burim Aliu, ZKF: Përshëndetje për të gjithë! Kjo është tash që e ka bërë Ministria ndryshimin e bartjeve të mjeteve. Ne e kemi dërgue sikur vitet e tjera, si çdo vit, tash ato mjete çka kanë qenë i ka bart në të njëjtat projekte ku kanë qenë. E keni te Propozim-vendimi për rialokimin, ku kanë qenë mjetet. Për shembull, ka projekt që i ka 0.50 euro. Tash na kanë thënë më bo rialokim brenda programit, me marrë me i bart ku na duhen neve si Komunë. Domethënë, e ka bërë ndryshimin e bartjes së mjeteve. Vetëm kemi të drejtë... s'na ka bart mjetet që e kanë tejkalue planin e të hyrave vetanake.

Munir Jonuzi: Pershendetje. Falenderoj këshilltarin e lartë financiar për këtë informacion. Mendova se ky ishte një gabim kur shtypja materialin këtu në komunë, nëse është nga ministria, atëherë nuk mund ta ndryshojmë dhe mbetet kështu. Për mua është e çuditshme se çfarë do të bëjmë me 50 cent, por nëse ky është vendimi i ministrisë, unë e mirëpres.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Atëherë, kush është pro që këto dy pika të kalojnë nesër në Kuvend? A ka kundër? Abstenim? Me 7 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, kalon rendi i ditës me dy propozimet që i dhamë. Atëherë kalojmë te pika e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? A ka abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet pika e parë. Atëherë vazhdojmë me pikat e rendit të ditës së seancës: Raporti për realizimin e buxhetit për periudhën janar-mars 2024. A do dikush me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi për të gjithë! Una pata qef një herë kryetari pak me na shpjegue, po s'është problem. Unë e kam veç një pyetje: Ndërtimi i stadionit dhe infrastrukturës përcjellëse në Dragash – 35 mijë euro. Kur janë bërë këto investime, se para dy-tri ditëve kam qenë unë atje, stadioni është në gjendje shumë të rëndë. Ajo salla aty ku bëhet përgatitja e fëmijëve dhe lojtarëve aty përmas, është shumë e vështirë. Unë s'po di qeto 35 mijë euro ku i keni harxhue këtë vit, ose me siguri ka qenë ndonjë investim i vitit të kaluar e ia keni pagesën këtë vit. Në qoftë se ka mundësi pak me na shpjegue.

Burim Aliu: Këto mjete kanë qenë vjet. Kryetari ka lidhë një Memorandum me Federatën e Futbollit. Këto mjete i kemi pas borxh. Nuk e di a e keni pa Raportin Vjetor të fundit, kanë qenë borxh. Hala i kemi na borxh, se në bashkëpunim me Federatën jemi borxh. Me bo me e pa Raportin Vjetor, i shohish që i kemi borxh. I kemi pas na diku nja 60 mijë euro, ose 100 e diçka mijë euro – nuk e di bash saktë.

Artan Loshaj: Shumë mirë pasi na shpjegoi që është borxh. Po due me e pyet kryetarin se çka është t'u ndodhë – masi jemi në këtë pikë, se kam pas edhe në eventuale me e pyet – çka është t'u ndodhë me stadionin e Graniçarit atje, kur në pushtetin e PDK-së kemi ndarë – unë si asambleistë me kolegët kemi ndarë 218 mijë euro. Vitin e kaluar i keni harxhue 230 mijë euro. Stadioni është në gjendje të rëndë, është në gjendje të mjerueshme, është aty veç zhavorri. Zhveshtorja është aty – s' di a keni qenë, javën e kaluar kemi qenë ne aty – se është edhe një kërkesë e qytetarëve edhe të klubeve sportive, në adresë teme për me jua adresue juve. Ndoshta edhe juve ju kanë ardhë këto ankesa. Brenda është në gjendje shumë të rëndë. Gjithë ai beton që është aty poshtë është trazue, është bërë, gjysmë metër ka dalë krejt, nuk mundesh as derën me e hap me hy brenda. Zhavorri është aty. Një hulumtim që e kemi bo, 500 mijë euro ka kushtue tepihu i San Siro-s, Milani e Interi ku luajnë, e 450 mijë euro po kushton – nuk po ju akuzoj juve, po ju akuzoj krejt si pushtet, se edhe PDK-ja i ka nda 218 mijë, edhe ju i keni nda 230 mijë – edhe stadioni është hala në zhavorr. Deri kur ka me u ndreq ky stadion, se vitin e kaluar i keni dhënë shumë prioritet stadionit të Dragashit dhe stadionit të Blaçit. As njëri e as tjetri s'u bo. Fëmijët tanë, të rinjtë tanë pyesin kur do të dalim me lujt në fushë, se s'kemi dhe ushtrime ku me bo. E kemi një ekip të futbollit, nja 60-70 fëmijë, luajnë hala në sallën e Edukatës Fizike në shkollën e mesme, 20 me 10. Dje kemi pas lojë, ata të ngratit s'un po ngasin se s'kanë ku me lujt, s'kanë ku me bo aktivitet. Deshta me e

marrë një informatë, z.kryetar, edhe me dëgjue edhe ata sportistët deri ku kemi mbërri me stadionin.

Munir Jonuzi: Unë kam vetëm një pyetje të shpejtë. Vë re se në këtë dokument nuk kemi paguar asgjë për shpenzimet e varrimit, më intereson se çfarë po ndodh me shpenzimet e varrimit, a i kemi anuluar shpenzimet e varrimit dhe nëse jo, si do t'i paguajmë në të ardhmen. Kodi 13490.

Bexhet Xheladini: Atëherë unë do t'ia jap një përgjigje Artanit. Ju siç e dini, Komuna e Dragashit ka lidhur një marrëveshje apo memorandum për bashkëfinancimin e ndërtimit të stadionit të qytetit (Komuna bashkë me Federatën e Futbollit të Kosovës). Aty në atë marrëveshje i kemi pas të ndara punët: Përgatitja e terrenit dhe vendosja e tepihut është bërë me mjetet nga Komuna e Dragashit, ndërsa zhveshtorja dhe rrethoja do të bëhet nga mjetet të cilat janë ndarë nga Federata e sportit. 90% e punimeve tokësore, sa i përket terrenit dhe stadionit, janë krye dhe terreni është përgatit për vendosjen e tepihut. Për vendosjen e tepihut neve na kanë thënë se duhet të jetë temperatura së paku 20 gradë. Tepihu nga Turqia ka ardhë dhe ne shpresojmë që brenda muajit, maksimumi brenda muajit maj, do të kryhen të gjitha investimet të cilat kanë qenë të parapara nga ana e Komunës së Dragashit. Si të kryhen këto investime, atëherë Federata do të fillojë me punimet e pjesës së vet të cilat i ka marrë përsipër. Ne vitin e kaluar nuk i kemi pas të gjitha mjetet me ia pague punëkryesit, këtë vit ne i kemi siguruar mjetet edhe pjesën më të madhe të mjeteve ia kemi pague. Kanë mbet vetëm shumë pak mjete me ia pague, të cilat i kemi dhe do të paguhen pas vendosjes së tepihut. Sa i përket shpenzimeve të varrimit, ju e dini që Ministria e Financave vitin e kaluar, pasi është miratuar edhe buxheti i Komunës së Dragashit edhe buxheti i Kosovës, ka pru një Vendim që shpenzimet e varrimit të mos paguhen nga mallrat dhe shërbimet, por nga subvencionet. Ju siç e dini, Asambleja Komunale vitin e kaluar, kur e ka miratue buxhetin, ka vendos që këto shërbime të paguhen nga mallrat dhe shërbimet. Mirëpo ne kemi gjet një zgjidhje dhe kemi lidhur një memorandum me “Ekoregjionin” - sepse “Ekoregjioni” në Prizren bën pagesën e shpenzimeve të varrimit për Komunën e Prizrenit - dhe ne kemi vendos që këto shpenzime të varrimit këtë vit të bëhen në bazë të memorandumit që e kemi lidhë me “Ekoregjionin”. Nuk do të ketë probleme sa i përket pagesës së shpenzimeve. Ndërsa, sa i përket borxhit prej 13 mijë euro, sapo ta bëjë alokimin e mjeteve Ministria e Financave, ne do ta bëjmë pagesën e borxhit të mbetur. Ne i kemi krye procedurat, vendimet i kemi bërë, mirëpo Thesari ende nuk e ka bërë bartjen e mjeteve nga Komuna në xhirollogari të Këshillit të Bashkësisë Islame. Faleminderit!

Artan Loshaj: Kryetar, po më vjen mirë që po thuesh 90% e punimeve janë bërë. Unë besoj që e ke vullnetin ti për me e krye, po punëtorët e tu që i ke në rreth vetes po më vjen se pak po të qesin në lojë. Aty është veç zhavorri i pjesës së parë – qysh me thonë – shtresa e parë. Shtresa e dytë – se edhe na e kuptojmë kapak futbollin, edhe na jemi të interesuar si opozitë ose si përfaqësues të qytetarëve – aty qe shtatë-tetë muaj asnjë cent, asnjë investim s’u bo. Është veç zhavorri i parë, këtë zhavorrin tjetër duhet me e shtrure, duhet me fjet ai zhavorri, ai i imëti, e masnej me u shtrure stadioni. Kryetar, nashta deri në vitin e ri mundesh me e bo. Unë po të them – prapë ti je doktor dhe prapë e kie vullnetin, po lojtarët që i ke mas vetit bajagi si Messi i kie, po ta kalojnë ndonjëherë edhe ty. Edhe nuk mora përgjigje për stadionin e fshatit Blaç.

Bexhet Xheladini: Dëgjo, shtresa e dytë e zhavorrit nuk bën me u qit. Shtresa e dytë e zhavorrit qitet menjëherë para se të vendoset tepihu. Nëse qitet më herët, prishet. Kështu që, punëkryesi na ka thënë këtë informatë, se na jemi interesue. Edhe njerëzit që i kam mbrapa meje janë njerëz të cilëve unë iu besoj. Unë jam një njeri i cili iu besoj njerëzve deri në atë moment kur e shoh që ata nuk po e kryejnë detyrën. Deri më tash nuk kam pas këso rast dhe unë punoj vetëm me njerëz të cilët janë të besueshëm dhe iu besoj. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! A do dikush tjetër? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pikës? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe 3 abstenime, e miratojmë këtë pikë. Kalojmë te pika e tretë: Propozim-vendim për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionerëve 01Nr.060/01-3947/22 /3 i datës 10.03.2022. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike?

Bexhet Xheladini: Unë propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës, për arsye se kam bërë një konsultim me “Ekoregjonin”, dhe ka ende kohë, edhe më shumë se një vit, për këtë çështje. Kështu që, nëse jeni të mendimit ne mundemi me e hek, por nuk është edhe gabim nëse e lëmë. Propozimi im është që kjo pikë mund të hiqet nga rendi i ditës.

Arijeta Skeraj: Atëherë, kush është që të largohet kjo pikë e rendit të ditës?

Artan Loshaj: Kërkoj falje! Kryetar, diqysh po më vjen se e more personale. Prapë s’e kam me ty, e kam me kryetarin e Komunës. Ne rendin e ditës, Arijetë, e votuam edhe u pajtuam 7 asambleistë, edhe të pozitës edhe të opozitës që qeshtu me shkue rendi i ditës. Tash në mes të lojës,

në mes të seancës, me u çue kryetari edhe me thonë me e largue, hajt për ne, por po shkoni kundër delegatëve të juaj.

Arijeta Skeraj: Okej, faleminderit! Pasi ishte kërkesë, e lamë në seancë me u vendos a do të hiqet nga rendi i ditës apo jo. Vazhdojmë te pika e katërt: Propozim-vendimi për inicimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032. Kush do me e marrë fjalën?

Qamil Kolloni: Përshendetje kryetar, kryesuese! Të nderuar delegatë! Ju e dini që në vitin 2023 ka skadue PZhK. Jemi të obliguar në bazë të ligjit përgatitim Planin e rid he për këtë arsye e kemi parë të udhës që të fillojmë procedurat. Një prej procedurave është Propozim-vendimi për fillimin e procedurave për përpilimin e PZhK-së.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, drejtor! A do dikush tjetër? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe dy abstenime, e miratojmë edhe këtë pikë të rendit të ditës. Atëherë kalojmë te dy propozimet që të shkojnë në seancë. Propozim- vendimi për tejkalimin e mjeteve vetanake të buxhetuara në vitin 2023 dhe të barten në vitin 2024.

Artan Loshaj: Kryetar, unë sa e kam lexue buxhetin e vitit 2024, po më duket janë – mos gabofsha – 60 mijë euro për asfaltimin e rrugës Dragash- Stadion. Qeto 32 mijë euro, a janë shtesë, a me qeto kie me krye këtë punimin? Buxhetin 2024 të Ministrisë, që e kam lexue unë, e kam marrë se më është dashtë, aty shkrun 60 mijë euro. Domethënë, qekjo qenka 32-shi edhe 27-shi. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Artan! A do dikush tjetër? Atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 7 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Propozimi tjetër është vendimi për rialokimin e mjeteve të buxhetit për vitin 2024. A do dikush me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Për këtë 50 centshin e Gllloboqicës u arsyetue që e ka bo Ministria. Po besoj që Ministrisë këto projektet ia ka çue Kuvendi Komunal, se ata vetë nuk i bëjnë këto. Deshta me pyet për në fshatin Rrenc – se qetash kur të foli thojnë qe ky, deri dje ka nga , e sot kundër pushtetit edhe për fshatin Rrenc – qetu në fshatin Rrenc janë nda 5 mijë euro. Shumë mirë, kryetar, është dashtë edhe pak më tepër me nda, po problemi është që keni qenë një ditë në Rrenc – ka qenë më duket edhe kryesuesja – i keni mat do rrugë nëpër fshat. Me 5 mijë euro a është e mundshme m'u

bo 5-6 rrugë, se – po po, u dok kryesuesja, mirë që u dok se bajagi e kam kritikue tjera herë, po më vjen mirë edhe kam qef unë jo LDK, po edhe GIG edhe VAKAT me na dhënë pare, na i marrim në Rrenc. Po problemi është që gjithë ato rrugë – se kam qenë në fshat para nja dy-tri ditëve – thanë e kanë bo një punë të madhe LDK-ja, i kanë mat nja 5-6 rrugë. Thashë ishalla dhjetë i matin, po 5 mijë euro, me qeto 5 mijë euro a mundeni me i bo këto a po na shtoni edhe ndonjë pare shtesë. Megjithëse s’po due me hy ma tutje, se e keni letrën, në prona private na keni akuzue ju si pushtet. Krejt janë prona private, po masi janë qytetarë të mi, unë kam me i mshelë sytë edhe kam me i përkrah. Deshta veç një njoftim, në qoftë se ka mundësi, me 5 mijë euro 5-6 rrugë nëpër fshat, s’po di unë, a veç ia keni nis fushatës këtë vit për vitin tjetër.

Uran Halimi: Faleminderit, kryesuese! Sinqerisht kryetar, me qeto 50 centët çka keni me bo? E ke kolonën 51554 – Ndërtimi i terreneve sportive në Glloboqicë, 50 cent. A kie me i bashkue dikund, a veç me qeto do t’bëjmë diçka. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Ndërtimi i terreneve sportive në Glloboqicë ka qenë projekt i vitit të kaluar. Nga mjetet që kanë qenë të ndara kanë mbet 50 centë. Ministria e Financave, mjetet që kanë mbet i ka qit prapë në projektin e vitit të kaluar. Unë thashë, kjo faqja e parë nuk është propozim i yni; ky është Vendimi që e ka pru Thesari, Ministria e Financave, që na i ka bart mjetet, në mesin e tyre është edhe qeky 50 centi. Fleta e parë është ata të cilët e kanë bërë alokimin e mjeteve në Komunë, na i kanë kthye prapë në këto projekte. Ne nuk i kemi kërkuar me na i kthye këtu, po kemi kërkuar në projektet të cilat i keni miratue ju në mbledhjen e kaluar. Kanë mbet mjete të pashpenzuara nga ky projekt i vitit të kaluar – 50 centë – edhe ai i ka kthye. Nuk është diçka qesharake kjo, se s’është e jona, po edhe MF-ja edhe 50 centshin që e ka kthye prapë, nuk është ky ndonjë vendim që duhet me ngrit peshë. Ndërsa, fleta e dytë është, do të thotë Vendimin që e ka pru Asambleja Komunale, këto mjete në cilat projekte duhet të kalojnë, në mënyrë që të realizohen këtë vit. Sa i përket 5 mijë eurshit, ky ka e qenë si trampolinë. Ne do të shpallim tenderin, këtë vit, për kubëzimin e të gjitha rrugëve të fshatit Rrenc, brenda fshatit, të cilat kanë mbet pa u kubëzue deri më tani. Edhe ne, me buxhetin e vitit 2025 do ta shpallim tenderin dyvjeçar. Ka kompani e cila e merr tenderin dhe i kryen punët sivjet e paret i merr në shkurt të vitit të ardhshëm. Kjo është. Edhe ju keni bo edhe ma herët. Kur e keni shpallë tenderin për ndërtimin e QMF-së në Krushevë, i keni ndarë 5 mijë euro, a projekti kushton 250 mijë euro. Edhe e keni shpallë tenderin, që është normale. Ne kemi ndarë edhe mjete diku 13 mijë euro për ndërtimin e

Impiantit të ujërave të zeza në fshatin Brezne. Po ai Impianti kushtin mbi 300 mijë euro, po na do ta shpallim tenderin sivjet, në mënyrë që vitin e ardhshëm të mos humbim kohë. Kjo është transparenca edhe kjo është ajo që duhet ta dish edhe ti, edhe qytetarët.

Artan Loshaj: Kryetar, të thashë edhe parëz: Kur të vjen për fshatin Rrenc, edhe ma allton shtro se kënaqesh, merre krejt Rrencin merre në Bresanë. Pa problem e kemi atë punë. Por, kur thaje ju e keni bo, në Rrenc është bërë një huti politike – unë për Rrenc po foli, për këtë 5 mijë eurshin – është bo një amulli në fshat, krejt rrugët sivjet po na shtrojnë. E pyeta edhe Arijetën, para se me dalë këtu, Arijeta tha i kemi do pare shtesë. Unë atyre duhet me ua shpjegue që me 5 mijë po e nisim, e me buxhetin e 2025-tës, domethënë me buxhetin e Kuvendit, jo të kryetarit të Komunës – se Arijeta parëz keni ra ndesh me Arijetën, ajo po thotë kemi marrë do pare shtesë, s’e di ku po i gje Arijeta, e ti qetash më thaje mu buxhetit të 2025-tës. Edhe ku e thaje për QKMF-në, i kie të njëjtit lojtarë të PDK-së ti – jo bre s’po të them kurgjo, mirë po të them ke bo se kanë qenë lojtarë të mirë ata, e i ke marrë ti – e ke marrë Beharin edhe këtë tjetrin të Brodit. Me 24 mijë euro çfarë kerr ki me ble, kryetar, se u mytët t’u ble kerra, krejt kerrat po na prishen. Po, ama çka po blejsh po due me pyet. Çfarë kerri është ky? Tash këtë kerrin s’po e blejmë, a? Jo jo, po na duhet kerri o kryetar, se të gjithë kerrat po na prishen rrugës. Natën e Bajramit kam mbet në rrugë unë me atë kerrin. E dish shumë mirë, ai kerri tjetër përmi 40 nuk ecën. Nejse, po ua shpjegoj qytetarëve që 5 mijë euro po e nisim rrugën, e me buxhetin e 2025-tës – në zgjedhjet lokale – do ta mbarojmë asfaltimin e rrugëve. Po de, me paret e buxhetit të 2025-tës paguhen këto rrugë, jo me paret që më ka thënë kryesuesja kemi me i gjet shtesë për fshatin Rrenc. Se Arijeta pak ma ka përzije.

Bexhet Xheladini: Blerja e automjeteve për QKMF-Dragash, 24 mijë e 148 euro, ky ka qenë projekt i vitit 2023. Atëherë kemi ndarë mjete me i ble dy automjete. Ndërkohë, Qeveria ka prur vendim që komunat nuk kanë të drejtë të blejnë edhe të shpallin tender për blerjen e automjeteve, për arsye se Qeveria ka zgjedhë një operator ekonomik i cili në nivel qendror do t’i furnizojë komunat me automjete. Ndërkohë, kur ka ardhë puna me e nënshkrue kontratën, Qeveria e ka zgjedhë operatorin ekonomik, njëri prej tyre është ndarë i pakënaqur edhe është ankue. Ankesa në OSHP nuk është shqyrtuar deri në fund të vitit. Edhe këto mjete ne s’kemi mujt me i ble kerrat, për arsye se Qeveri nuk ka mund me e lidhë kontratën me operatorin ekonomik që e ka fitue tenderin, sepse lënda ka shkue në OSHP. Edhe sot e kësaj dite është lënda në OSHP, edhe ne nuk kemi mund me i ble këto automjetet. E mira e kësaj është se këto kanë qenë mjete vetanake, edhe

nuk na kanë humb. Përndryshe, me pas qenë mjete të Grantit, ne sot nuk kishim mund me vendos me i kthye ato mjete prapë. Por, kanë qenë të hyra vetanake dhe sot ne mund t'i shfrytëzojmë këto mjete pa i humbur. Ne nuk po i blejmë më automjete, sepse prapë problemi në nivel qendror nuk është zgjidhë për blerjen e automjeteve – ka mundësi që nuk mund të zgjidhet fare – kështu që, për mos me rrezikue prapë, ne këto mjete i kemi orientue prapë në investime kapitale në shëndetësi, por me gjysmën e këtyre mjeteve do të bëhet renovimi i QKMF-së dhe Emergjencës, edhe një pjesë e mjeteve do të shkojë në QMF-Krushevë.

Munir Jonuzi: Faleminderit. Unë do ta mirëpres këtë vendim për arsye se të gjitha këto janë projekte, gjegjësisht investime kapitale për të cilat janë bërë projekte, por nuk janë realizuar për arsye të ndryshme dhe arsyeja më e shpeshtë ka qenë për shkak të borës. Pra, kontraktorët nuk arritën t'i përfundojnë këto projekte. Nga ky podium do t'i kërkoja presidentit që të ndikojë në drejtorinë e urbanistikës dhe kadastrës, të ndikojë në drejtorinë e financave, te prokurimet publike, që këto tendera, këto investime kapitale t'i nxjerrin në ankand publik. Për faktin se ne kemi krijuar tashmë projekte për të gjitha këto investime kapitale, duhet vetëm të shpallim tender. Sa i përket blerjes së automjeteve për QKMF-në, vitin e kaluar kemi ndarë mjete të caktuara për blerjen e një autobusi shkollor për nevojat e nxënësve jo shumicë. Pastaj theksova lëshimin se kalon përmes QKMF-së, por që autobusi kalon nëpër drejtorinë e administratës, tani e shoh që autobusi nuk është blerë dhe se mjetet janë dedikuar për disa gjëra të tjera.

Bexhet Xheladini: Vërejtja e Munirit është me vend, sa i përket azhuritit të Drejtoratit të Urbanizmit. Por ne e kemi një problem me hartuesin e projekteve, për atë edhe janë bërë disa vonesa. Sa i përket blerjes së autobusit, kemi pas mjete na në shëndetësi edhe kemi vendos që autobusi të blehet nga mjetet në shëndetësi, sepse këto janë të hyra vetanake. Por tani nuk do të blejmë kombibus, për arsye se kemi bërë kërkesa te disa donatorë për dhurimin e autobusit. Kemi premtime. Por gjithashtu, ne kemi marrë edhe vendim që transporti i nxënësve, si në pjesën e Gorës dhe Opojës do të bëhet me tender dhe me kompani private. Kështu që, nxënësit e komunitetit joshumicë, në vitin që po vjen nuk do të kenë pengesa sa i përket transportit të nxënësve, pavarësisht a do të sigurohet minibusi apo do të gjendet forma tjetër përmes ofertimit apo tenderëve. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër

dhe tre abstenime, e miratojmë këtë pikë. Atëherë vazhdojmë me pikën e fundit, pikën eventuale. A do dikush me e marrë fjalën?

Munir Jonuzi: Kryetar, do të doja të përfitoj nga prania juaj në këtë komision dhe t'ju drejtohem si kryetar i komisionit komunal të regjistrimit. Meqenëse regjistrimi tashmë ka filluar, dhe regjistruerit janë në terren, do t'ju informoj për problemet që lidhen me të. Gjegjësisht, siç e dini, Agjencia e Statistikave të Kosovës ka bërë një gabim në përkthim, duke e zëvendësuar nacionalitetin boshnjak me kombësinë boshnjake. Sigurisht, ky është një dështim i madh i agjencisë, thjesht nuk është e kuptueshme për mua që ata nuk kujdesen aq shumë për komunitetet, veçanërisht për kategoritë kushtetuese të komuniteteve. Se nuk e dinë emrin e vërtetë të komunitetit që ka tre ulëse të rezervuara në parlamentin e Kosovës. E cila ishte ndër të parat që u integrua në këtë shoqëri. Një lëshim dhe padrejtësi e madhe e agjencisë ndaj njërit prej komuniteteve më të shumta në Kosovë. Mirëpo, agjencia e ka korrigjuar gabimin para dy javësh, por këtu në komunën tonë ende e kemi atë problem, termi bosanac nuk është zëvendësuar me termin boshnjak nga të gjithë regjistruerit. Nuk do të flas për teori të ndryshme, megjithëse kam hapësirë këtu, por kjo do të ishte e pavlerë nga ana ime. Unë thjesht do t'ju kërkoj juve si kryetar i komisionit komunal të regjistrimit t'i thërrisni të gjithë regjistruerit, t'i thërrisni përfaqësuesit e agjencisë së statistikave për të sinkronizuar ose përditësuar të gjitha tabletët, në mënyrë që termi boshnjak të mos shfaqet më. Sepse kështu më duket se disa mbikëqyrës i shmangen zgjidhjes së këtij problemi dhe kjo shkakton tallje dhe poshtërim ndaj komunitetit boshnjak. Natyrisht, kur them që ju thërrisni përfaqësuesit e agjencisë dhe bëni një kontroll, nuk ju referohem personalisht, keni edhe shtatë apo tetë anëtarë në atë komision komunal të regjistrimit, keni edhe mbikëqyrës, le të merren me këtë problem dhe se deri në fund të regjistrimit nuk duhet të përdoret më termi bosanac, por boshnjak, sepse siç e vërej po shkon shumë ngadalë. Faleminderit

Artan Loshaj: Kryetar, po lidhem qetu në eventuale, se nuk deshta me të bo replikë. 14 mijë euro renovimi i QKMF-së. Në vitin 2022 e ke pre shiritin e Urgjencës, a për dy vjet erdh puna me u renovue Urgjenca, a? Se 14 mijë euro renovimin edhe thaje gjysat shkojnë në Urgjencë. Po due me e ditë. Edhe, i kam nja dy-tri pyetje. Ndriçimi i rrugës Pllavë-Viva Fresh, e kam videon, asnjë dritë nuk punon. Qytetarët dojnë me e ditë çka është problemi. Qekjo është e ndijshme kryetar, edhe po të luti – si asambleist i opozitës, pse po e diskutoj këtë, mos me ma marrë mu për të keq, për inat temin mos me shkue me e bo. Se i kam edhe do shkrime, zyrtari i Komunës me qytetarët

e fshatit Kapre edhe fshatit Rrenc që i ka bo. Rruga Kapre-Rrenc, që po bëhet asfaltimi, është afër përfundimit. Me vullnetin tënd – edhe të kryesueses, pasi vjen prej fshatit Rrenc – është mirë, në hyrje të fshatit Rrenc është një tatëpjetzës e madhe, nja dy metër me ra ma poshtë bëhet shumë mirë. E kanë bo një kërkesë edhe qytetarët e Rrencit, edhe qytetarët e Kapres, edhe shumë qytetarë të Komunës, se s’është veç rruga Kapre-Rrenc, po ka me kalue Zaplluxhe-Dragash. Është mirë një rrafshim të rrugës me e bo, se është një tatëpjetzës shumë e madhe, edhe sa s’janë bo punimet është mirë, një ditë ose dy ditë punë ka me punue me bager aty. I kanë thënë këtij zyrtarit – me emër po ta them, Sabahatit – i kam shkrimet. Ti e dish shqiptarët qysh e kemi na, pse Artani po e lyp, për inat të atij. Për këtë rrugë, se është rrugë nacionale, mos të shkojmë në inate personale, ose fshat me fshat ose zyrtari me atë. Është mirë me dalë vetë në vend të ngjarjes, mundim me e marrë edhe Arijetën me shkue me e pa. Jo, është shumë serioze ti Uran, se edhe ti kie me kalue aty pari. Unë kam qenë aty pari, jo po thojnë se kur të bjer borë fle bora aty. Punë e madhe që po flejka bora. Nuk është me rëndësi, puna tjetër është kryetar, në fshatin Kapre, në vitin 2023 edhe në 2024 asnjë investim s’është. Edhe pse një dokument e pashë, po s’deshta me e pru këtu – nëse dësh, nesër ta bie, me nënshkrimin tënd ish – që ju ke thënë qytetarëve të fshatit Kapre që kry projekt që keni kërkuar si fshat ju ka kaluar në Asamble. I mora ata tre-katër qytetarë si përfaqësues të fshatit...nesër ta lexoj, se tash s’e kam me veti, tash mos të foli në Kuvend pa lidhje. Zyrtari yt Vetimi na pa bashkë, thashë o Vetim s’kam ardhë me prish punë, kemi ardhë me ndreq punë. Shkuem e kqyrëm aty, për investimet 2024 nuk ka. Nashta është bërë ndonjë lëshim aty, ama nuk ka investim, 2023 asnjë cent dhe 2024 – për këtë vit – asnjë cent, fshati Kapre si fshat nuk ka. Domethënë, me siguri është bërë ndonjë lëshim nga ana juaj. Edhe, për mos me dalë më këtu, është edhe një kërkesë e punëtorëve të QKMF-së, të cilët i ke mbështet fuqishëm edhe të jemi mirënjohës për koeficientin. Ujdia e punëtorëve që është bo me avokatin, ujdia më avokatin e Komunës edhe Gjykatës, sot dy muaj është dashtë me u bo pagesa. Hala nuk është bo, kryetar. Avokati na ka thirrë në telefon, që do të shkojmë me bo padi përmes përmbaruesit. Në seancën e parë, më 21 mars, qetu me ke thënë kryetar, kjo punë u krye, dokumentet kanë shkue. Sot është 29 prilli, hala 15,900 euro nuk i janë lëshue punëtorëve.

Uran Halimi: Përshëndetje, faleminderit znj.kryesuese! Unë deshta me e pyet kryetarin, po më pyesin qytetarët kryetar, zakonisht kur po më shohin, po më thonë ti i VV-së po folish, a mundish me e pyet kryetarin gjë po bohet me urën e Qollopekut atje poshtë. Shumë keq, s’po kalohet, prapë po duhet me hi nëpër rekë, po thojnë qytetarët. Te ura e Zaplluxhes, prapë Xhyllferies ia lujte lojën,

ta lëshoj vendin me e vonue urën, s'e bone kryesuese, as urën s'e ndreqe. Hiç e mirë kjo. E kie një rrugë aty të vorrast e Zaplluxhes, është 1 metër e 20 e gjonë, ka përmi vorras që hi në mahallë te xhamia. E promovove me shumë selfie – po po, me selfie po – edhe e laje në gjys. A mundish te qeto urat me shkue me e bo ka ni selfie, shko edhe pak te stadioni i Blaçit qite deni selfie, se kohën e fundit hiç s'të kemi pa kryetar me atë stilin e selfieve që mu më pëlqen. I nderum Qamil, del pak vizitoi punimet, deri në dje kryetar i LDK-së je konë, jau ke marrë votat qytetarëve, kqyre çka është t'o ndodhë. Qato urat janë shumë të mira – urat – sidomos qato të Zaplluxhes. Nëse ka dështue, hiqe krejt, bone ni qetor o kryetar. Përveç që s'e keni ndreq atë urën e Zaplluxhes, ajo iu ka shkaktue shumë aksidente edhe qytetarëve, s'e di a je në dijeni? Jau u ke vështirësue jetën qytetarëve me atë urën, e ke bo një monument aty të trishtueshëm, sidomos natën, as ndriçim as kurgjo, kogja telashe po jus jell qytetarëve. Më kanë thonë qytetarët me të pyet, kryetar. Faleminderit shumë!

Bexhet Xheladini: Atëherë, sa i përket regjistrimit të popullsisë, të gjitha ato që i tha Muniri qëndrojnë. Ky nuk është vetëm problem i Komunës sonë, por është problem nacional i tërë Kosovës. Boshnjak nuk ka vetëm në Dragash, po ka edhe në tërë Kosovës, e sidomos në Komunën e Prizrenit edhe në Komunën e Pejës. Është bërë një gabim edhe me sa kam informata ai gabim është përmirësuar. Mirëpo ka ngjallë huti te regjistruerit, edhe tek ata të cilët deklarojnë përkatësinë nacionale. Nesër është thirrë një mbledhje urgjente e Komisionit për Regjistrimin e Popullsisë në nivel qendror. Nënkryetari i Komunës dhe një anëtar i Komisionit Komunal do të marrin pjesë nesër në atë takim. Në bazë të instruksioneve që do t'i marrin atje, menjëherë brenda javës do ta thirrim një takim urgjent me të gjithë regjistruerit e Komunës së Dragashit dhe do ta zgjidhim këtë problem. Do të jeni edhe ju i ftuar, z.Munir, aty si zv/kryesues i Kuvendit. Do të thirret edhe kryesues i Komitetit për Komunitete në atë takim, Miralem Rahte. Do ta marrim një qëndrim rreth këtij termi. Po ashtu, ne kemi problem edhe me regjistruerit, sidomos ata të komunitetit boshnjak, të cilët sa po e pranojnë detyrën, po punojnë një ditë ose dy edhe po japin dorëheqje. Ky problem është i shprehur sidomos në fshatin RestelicëSa i përket rrugës së Rrencit, te ajo përpjetëza që e përmende, unë dje kam qenë. Ka qenë edhe mbikëqyrësi, Sabahati, po ai ka qenë pavarësisht prej meje, unë kam qenë privatisht. Është një problem, edhe unë e kam vërejt që ajo përpjetëza duhet të korrigjohet. Do të bisedoj me mbikëqyrësin e punimeve, me Sabahatin, edhe çka ka mundësi me u zgjidhë ai problem, do të zgjidhet. Sa i përket urës së Qollopekut, tenderi është shpallë si fazë e dytë. Tenderi i parë është krye. Vitin e kaluem është shpallë tenderi,

për shkak të borës s'ka mujt me u krye, do të kryhet tash. Kështu që, edhe këtë brengë po ta hek. Ura e Zaplluxhes, ju e dini që unë kam bërë përpjekje të vazhdueshme për me u ndreq ajo urë. Falë pronarit të truallit, i cili e ka dhënë vullnetarisht, pa pagesë, e ka dhënë lejen që ajo rrugë të ndreqet. E kemi bërë një memorandum unë bashkë me babën e Xhylferies, pas këtij memorandumimi ka fillue ndërtimi. Mirëpo, puna ka ngec. Nuk është investitor edhe shpallës i tenderit Komuna, është Ministria e Infrastrukturës. Mbikëqyrjen e ka bërë MI-ja. Mbikëqyrës është Ferit Tafallari. Unë së paku, nashta nja 30 herë kam pas takim me të për këtë urë. Ata nuk e tregojnë arsyen pse është ndërprerë. Unë javën e kaluar i kam siguruar disa fotografi me ngjyra, kam pas takim me zëvendësministrin e Infrastrukturës, me të cilin e kemi nënshkrue një memorandum. Ministria këtë vit do të fillojë dhe ka ndarë mjete në vlerë prej 350 mijë euro për asfaltimin e rrugës Zliptok-Brod. Kështu që, atë ditë e kemi bërë memorandumimin dhe së shpejti pritet edhe shpallja e tenderit. Edhe atë ditë, unë me zv/ministrin me të cilin unë kam shumë raporte të mira – edhe është një prej zëvendësministrave ndoshta më të mirit që ka Qeveria – unë me atë e kam diskutue dhe çështjen e urës së Zaplluxhes. Ia kam dhënë edhe fotografitë, edhe ai ka premtue se këtë çështje do ta çojë përpara. Gjithashtu, kam kërkue që të fillojë edhe asfaltimi i Stacionit të Autobusëve, se vitin e kaluar e kemi nënshkruar një memorandum që Ministria ta kryejë këtë punë. Gjithashtu, edhe për çështjen e transportit të zyrtarëve Prizren – Dragash. Qe një vit e kemi bërë kërkesën në Ministri, edhe aty më dha premtim që këtë çështje do ta çojë përpara. Edhe për rrugën Blaç-Bjeshkë, për të cilën ty të kam lut kushedi sa herë po nuk ke shkue, me e bo një intervenim bare të vogël. Zv/Ministri premtoi se do ta fut atë në buxhetin e rregullt për vitin 2025. Për urën ta thashë, e kam njoftue zv/ministrin për problemin e urës, ai tash i ka të gjitha njohuritë. Tash a qëndrojnë apo jo, kjo është punë tjetër, po unë atij ia kam thënë. Kështu që, unë besoj që ky problem i udhës do të zgjidhet.

Uran Halimi: Kryetar, mu më pëlqen ky aktrimi yt, kurse s'po dish që bojsh. Valla po, e ke shumë specialitet këtë që bojsh kurse s'po dish. Nuk munden kryetari i Komunës mos me e ditë ku ka ngec puna e urës. Ti e dish shumë mirë, se edhe qytetarët e dinë këtë. Po kryetari bën kishe s'po di. Më ke thonë, kur s'po dish pyet. Unë ju kam thonë edhe në seancë, publikisht, që materiali, betoni është i cilësisë tepër të dobët aty që u hedhë, edhe armaturën lepri ia ka hongër, ka mungesë të armaturës. Na kryetar kemi kalue kah rruga e Pllavës, edhe e dish çfarë urë u bo aty, edhe sa hekur është investue në të. E, te ura e Zaplluxhes realisht unë nuk e kam pa, ma pak, bon vaki as gjysma e sasisë së hekurit. Kjo është arsyeja pse të janë ndërprerë punimet, se mbikëqyrësit i kie llom.

Edhe, është mirë kur s'ë dimë ku ka ngec, qe na po të ndihmojmë, ta kalojmë këtë ngërç të urës së Zaplluxhes. Më kallxo çka me bo, edhe na si delegatë, nash po e bëjmë një reagim, nash po bëjmë protest, qyshdo që ta merr mendja ty, meqë me rëndësi është që ura me u ndreq. Cilado qoftë forma, unë po ta jap mbështetjen time, besoj që edhe këta delegatët tjerë nuk kundërshtojnë. Cilado qoftë mënyra, unë ta jap mbështetjen teme, veç ajo ura le të bëhet e kalueshme. Se është e nevojshme, është edhe rruga që neve na çon në Prizren, zakonisht na Blaç-Zaplluxhe e shfrytëzojmë atë pjesën. Ne të Blaçit gjithmonë shkojmë kah Zaplluxhja në Prizren. Mandej, pse s'i thaje zv/ministrit edhe për atë rrugën e Zaplluxhes që na çon në Prizren. Janë do gropa aty, kur vijnë natën a e dish sa tutem mos po bie në to me gjithë kerr. A ecish ndonjëherë andej, kryetar? Shoferat e traktorëve tu shkojnë e pastrojnë atë rrugën, nashta të kanë kallxue që në dy-tri vende ka rrëshqit rruga, është prishë, është e pakalueshme. Mundish nesër me thonë nuk i përket territorit tonë, po është rruga jonë. Se edhe rruga Dragash-Zhur, në Trokanin s'i përket territorit tonë, po është lobue po edhe është investue për ne. Edhe qajo rruga e Lezit që na i themi, rruga e Pouskës, valla është në gjendje të mjerueshme. Sidomos menjë pjesë ku koxha ka fjet ajo rruga, aty me bo mos me pas kujdes e mos me e ditë qytetarët, vazhdimisht ka aksidente edhe dëme materiale në vetura të qytetarëve. Po besoj që je duke më mirëkuptu, s'jam t'u ta thonë me tendencë këtë pjesë, as të urës, as të urës së Qollopekut, e sidomos të rrugës së Pouskës, nuk jam t'u ta thonë me tendencë. Është mirë me punue në këtë drejtim, që me ua lehtësue qytetarëve transportimin, transportin, rrugën edhe jetën në përgjithësi. Faleminderit shumë, kryetar! Përkrahjen time e kie për punë të mira, prapë unë jam qaj që jem konë edhe para dy vjetëve. Çkado që ka nevojë, lirisht më informo, më thirr, jam i gatshëm, edhe kur fle ditën jam i gatshëm prapë, çohem për ty. Jo për ty, për qytetarët.

Bexhet Xheladini: Sa i përket ndriçimit në Pllavë, Komuna e ka krye projektin, është bërë kërkesa në KEDS me e vendos orën edhe me u lëshue dritat. KEDS-i ende nuk e ka vendos orën, kështu që kur të vendoset ora lëshohen edhe dritat. Është problemi te KEDS-i, ata po i neglizhojnë punët. Sa i përket investimeve në Kapre, ka qenë një projekt vitin e kaluar, ka dështuar, s'ka mujt me u krye, paret kanë shkue në suficit. Uran, ura në Zaplluxhe, ato që i thaje, armature, betony etj., nuk ka kurgjo zyrtare. Ti mujsh me folë si delegat, po unë si kryetar nuk është mirë me folë diçka që ndoshta nuk është e vërtetë, ndoshta është e vërtetë. Unë nuk e di të vërtetën se pse u ndërpre, unë e kam pyet mbikëqyrësin e punimeve, ai është i Ministrisë, nuk është i Komunës. Edhe investitori është Ministria, asnjë cent ne nuk e kemi dhënë si Komunë. Ne vetëm e kemi sigurue truallin, falë

qytetarit nga Zaplluxhja i cili ka lejue që këtu të ndreqet ura, pa pagesë, pa kompenzim, pa kurgjo. Operatorët i ka gjet Ministria – KAG'i, ai i cili e ka bërë rrugën për Brod, ai ka pas me e bo edhe urën. Kështu që, në këtë drejtim unë nuk mund të them diçka që nuk e di. Për rrugën e Pouskës, ke të drejtë, unë kam kalue para dy dite, edhe ajo është rrugë regjionale, nuk është kompetencë, po mirë është të mundet me e bo një intervenim që atë rrugë me e bo. Edhe, nëse s'mujsh me ndihmue, bare mos pengo! Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! Faleminderit për pjesëmarrjen, e mbylli këtë takim!

Kryesuese e KPF-së

Arijeta Skeraj